REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 306120
Data/Datum. 01.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Blerina Huruglica- Eksperte Shqyrtues ***Shqipe Hoti-Eksperte Shqyrtuese***	***Data e autorizimit të ekspertit*** 21.05.2020	*Data e dorëzimit të raportit* *01.06.2020*

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.05.2020, OE "Alfa.I Shpk", ka parashtruar ankesë me nr: 306/20, kundër Njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull të prokurimit: "**Projektimi dhe Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluese**" me nr. të prokurimit: **624-18-5071-5-1-1**,dhe numër te brendshëm 624-18-060-511, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Suharekë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 3.500.000,00 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë 16.07.2018, data e hapjes së ofertës 27.08.2018, data e njoftimit për dhënien e kontratës 27.04.2020, data e njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit 08.05.2020

Lidhur me këtë lëndë janë nxjerr pesë vendime të mëparshëm nga OSHP-ë, vendimi me nr. 593-605/18, vendimi me nr 51-53/19, vendimi me nr 195/19, urdhëresa me nr 63/19, vendimi me nr 915/19, dhe vendimi me nr 138,162/20 me datë 02.04.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues në ankesën e tij pretendon se është duke u diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit për shkak të neglizhencës së AK-së gjatë vlerësimit dhe rivlerësimit, ku sipas OE shihet si pretekst kjo neglizhencë e tyre që të mos shpallen fitues.

I njëjti mendon se ky aktivitet i prokurimit është anuluar për arsye të tjera dhe jo për mungesë buxheti.

Sepse AK-ja ka nxjerr disa vendime të ndryshme dhe kundërthënëse që nga fillmi i vlerësimit të parë:

1. Në vendimin e datës: 10.10.2018 është rekomanduar për kontratë TEHNIX D.O.O,
2. Në vendimin e datës: 21.01.2019 është anuluar aktiviteti i prokurimit,
3. Në vendimin e datës: 18.04.2019 është rekomanduar për kontratë VGP DRAVA Ptuj,
4. Në vendimin e datës: 28.08.2019 është rekomanduar për kontratë TEHNIX D.O.O,
5. Në vendimin e datës: 29.11.2019 jemi rekomanduar ne për kontratë (Alfa.i),
6. Në vendimin e datës: 20.02.2020 është anuluar aktiviteti i prokurimit.

OE kërkon që ky vendim të anulohet dhe ky aktivitet të kthehet në rivlerësim.

Në këtë rast OE pretendon se AK-ja ka shkelur nenet: 1, 7, 9,59, 62 , 108 A, si dhe nenin 44.5 të Rregullave dhe udhëzuesit operativ për Prokurim Publik.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

1) OE shpjegon se me datë 27.04.2020 është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin *"Komuna Suharekë me datë 10.04.2020 ka pranuar shkresë(e-mail) nga Sekretari i Ministrisë së Infrastrukturës, ku na sqaron lidhur me projektin Ndërtim i impiantit të mbeturinave ricikluese në Suharekë, se Qeveria e Kosovës gjatë planifikimit të buxhetit me Qarkorën e dytë buxhetore këtë projekt e ka hequr nga linjat buxhetore, dhe se ky projekt nuk është paraparë në buxhetin e vitit 2020".*

I njëjti pretendon se ky vendim është vetëm një arsye kinse për mungesë të buxhetit, në të kundërtën ky aktivitet i prokurimit është zvarritur që nga viti 2018 e që kjo arsyeja për mungesë buxheti nuk qëndron sipas OE ankuesit.

2) Gjithashtu OE shpjegon që: *me datë 14.05.2020 kemi kërkuar një sqarim edhe nga KRPP-Help Desk-u i tyre në lidhje me kërkesën tonë se mos ka pasur ndonjë problem, ndërsa me datë 15.05.2020 kemi pranuar përgjigje nga KRPP-ja ku sqaron se kërkesa për rishqyrtim është bërë me datë 04.05.2020 në prokurim, e që kuptohet që ka qenë brenda afatit ligjor pasi që njoftimin mbi vendimin e kemi pranuar me datë 27.04.2020, ndërsa dita e pestë i ka rënë dita e shtune, ditë vikendi, kurse ne e kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim të hënën me datë 04.05.2020.*
Pastaj KRPP ka sqaruar se kërkesa për rishqyrtim është pranuar me datë 04.05.2020 dhe AK-së i ka shkuar njoftimi- notifikimi dhe natyrisht prej atij momenti AK-ja ka mundur ta shkarkon kërkesën për rishqyrtim.

Gjë që deri më tani nuk kemi pranuar mbi refuzimin/aprovimin e kërkesës tonë për rishqyrtim nga ana e AK. Ndërsa AK-ja me datë 08.05.2020 e ka publikuar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit në mënyrë kundërligjore, sepse ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe nuk na ka kthyer përgjigje, duke mos respektuar nenin 108/A të LPP-së dhe duke mos pezulluar aktivitetin e prokurimit deri ne shqyrtimin e ankesës sonë, por që ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit. AK-ja nuk ju ka përmbajtur afatit ligjor për shqyrtim te ankesave maksimalisht 6 ditë, e që pastaj fillon të rrjedhë afati ligjor për parashtrimin e ankesës në OSHP 10 ditë.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Në vendimin 915/19 është vendosur mbi përgjegjshmërinë e OE"ALFA.I" SHPK, ku është konstatuar se i njëjti OE është i pa përgjegjshëm, sepse Diploma për inxhinier është në gjuhën italiane. Po ashtu për OE në fjalë është vendosur edhe në vendimin e OSHP-së PSH nr.138,162/20.

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE shpjegon se me datë 27.04.2020 është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin "Komuna Suharekë me datë 10.04.2020 ka pranuar shkresë(e-mail) nga Sekretari i Ministrisë së Infrastrukturës, ku na sqaron lidhur me projektin Ndërtim i impiantit të mbeturinave ricikluese në Suharekë, se Qeveria e Kosovës gjatë planifikimit të buxhetit me Qarkorën e dytë buxhetore këtë projekt e ka hequr nga linjat buxhetore, dhe se ky projekt nuk është paraparë në buxhetin e vitit 2020".

Eksperti shqyrtues sqaron se duke pas parasysh faktin se AK nuk ka bashkangjitur ndonjë dëshmi qe tregon arsyen e anulimit te këtij aktiviteti te prokurimit, eksperti me dt. 29.05.2020, ka dërguar email AK-së, duke i kërkuar dëshmitë qe AK është thirrur për anulim te këtij aktiviteti te prokurimit.

AK me dt. 29.05.2020, ka kthyer përgjigje duke dërguar korrespodencën si me poshtë:

From: Avdullah Berisha
Sent: Friday, April 10, 2020 9:35 AM
To: Izedin Bytyqi
Cc: Ismail Rudari; Bali Muharremaj; Agim Bylykbashi
Subject: RE: Kerkese per Informata shtesë

Sqarime lidhur me Projektin: Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluake në Suharekë. MMPH në vitin 2018 kishte nënshkruar memorandum bashkëpunimi për ketë Projekt ne vlerë prej 3,500,000.00€ i ter buxheti i nder për ketë projekt ka shkuar ne suficit buxhetor, edhe ne vitin 2019 kishim te ndarë buxhetin për ketë Projekt ne vlerë prej 1,514,759.00€ qe i ter buxheti ka shkuar ne suficit buxhetor, andaj gjet planifikimit

buxhetit me Qarkoren e dytë buxhetore ketë projekt e ka hequr nga linjat buxhetore ish ministri z. Matoshi . Por i nderuar z. Kryetar ju kishte paralajmëruar edhe krye shefi ekzekutiv z. Ilir Morina përmes postes elektronike me datën 15 Nëntor qe ky Projekt nuk do te jetë ne buxhetin e vitit 2020.

Lidhur me pretendimet e OE ankues se që deri më tani nuk kemi pranuar mbi refuzimin/aprovimin e kërkesës tonë për rishqyrtim nga ana e AK. Ndërsa AK-ja me datë 08.05.2020 e ka publikuar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit në mënyrë kundërligjore, sepse ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe nuk na ka kthyer përgjigje, duke mos respektuar nenin 108/A të LPP-së dhe duke mos pezulluar aktivitetin e prokurimit deri ne shqyrtimin e ankesës sonë, por që ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit. AK-ja, nuk ju ka përmbajtur afatit ligjor për shqyrtim te ankesave maksimalisht 6 ditë, e që pastaj fillon të rrjedhë afati ligjor për parashtrimin e ankesës në OSHP 10 ditë.
Eksperti shqyrtues sqaron se në shkresat e lendes të dorëzuara nga AK, shihet se AK ka bashkangjitur vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim te OE ankues , vendim ky i dt.15.05.2020.
Eksperti shqyrtues sqaron se ne pajtim me nenin 6 të Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, AK është i thirrur që menjëherë pas pranimit të një kërkesë për shqyrtim të bej pezullimin e aktiviteti te prokurimit, andaj ne rastet tjera AK duhet te ketë parasysh depozitën e lartcekur dhe e njëjta te respektohet nga AK.

Eksperti shqyrtues konstaton se duke pas parasysh faktin se çështja e përgjegjshmërisë se OE ankues OE"ALFA.I" SHPK, është vendosur me vendimin PSH nr. 915/19, PSH nr.138,162/20. vijmë në përfundim se çështja e përgjegjshmërisë se OE në fjale konsiderohet si çështje e gjykuar (res judicata), nga OSHP.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues hedhet si e pa lejuar, vërtetohet vendimi i AK-së, Njoftimi për anulim te aktiviteti te prokurimit me titull "Projektimi dhe Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluese" me nr. të prokurimit: 624-18-5071-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Suharekë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA

ZYRA E PROKURIMIT
Nr. 011/2020
Nr. Protokolli: 43/2020

Për:	**ALFA.I shpk, Lipjan**
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	**VENDIM**
Datë:	**15/05/2020**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 04.05.2020 të parashtruar nga Operatoret Ekonomik: **ALFA.I shpk** , Lipjan lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Projektimi dhe Ndertimi i impiantit te mbeturinave ricikluese,** me Nr. të Prok: **624-18-5071-5-1-1** nxjerr këtë:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës 04.05.2020 e Operatorit Ekonomik: **ALFA.I shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Projektimi dhe Ndertimi i impiantit te mbeturinave ricikluese,** me Nr. të Prok: **624-18-5071-5-1-1**, kundër Njoftim per Vendimin e AK–së, të datës 27.04.2020 të publikuar në platformen elektronike.

2. ***Vërtetohet*** **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë:** 27.04.2020.

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën: https://e-prokurimi.rks-gov.net.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 04.05.2020, ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit "**Projektimi dhe Ndertimi i impiantit te mbeturinave ricikluese,** me Nr. të Prok: **624-18-5071-5-1-1**, kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të datës 27.04.2020 të publikuar në platformen elektronike. Mirpo nga AK Suharekë mbrenda kohes te percaktuar nuk është vrejtur kerkesa për ri-shqyrtim dhe me date 08.05.2020 ka bere njoftimin mbi anulimin e procedures, deri ne pranimin e, e-maili te dates 14.05.2020 nga OE Alfa I., ku na njofton se ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Mirpo me marrjen e E-mailit nga OE, AK-Suharekë ka komunikuar me KRPP përmes telefonit dhe është këshilluar qe të shqyrtoj kerkesen tuaj dhe te vendos mbi te.
Andaj Autoritetit Kontraktues pasi analizoi dhe shqyrtoi kërkesen tuaj, vendosi që të refuzoj kërkesen tuaj për arsyje se Ak-Suharekë, ka pranuar E-mailin nga Sekretari i Ministrisë së Infrastruktures dhe Ambientit,

From: Zyra Prokurimit Suhareke
Sent: Wednesday, May 27, 2020 11:20:45 PM
To: Blerina Huruglica
Cc: Shqipe Hoti; Bali Muharremaj
Subject: FW: Kerkese per Informata shtesë

Pershendetje!

Sipas kerkeses suaj po ua percjelli e-mail e marrë nga Ministria e Infrastruktures, lidhur me me projektin per Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluake në Suharekë, me te cilin e kanë hequr nga linjat bugjetore.
Sinqerisht,
ZP- Suharekë

From: Bali Muharremaj
Sent: Friday, April 10, 2020 9:10 AM
To: Zyra Prokurimit Suhareke
Subject: Fw: Kerkese per Informata shtesë

Bali Muharremaj
Mayor of Municipality of Suhareka
****
Kryetar i Komunës së Suharekës
Komuna Suharekë
Rr. "Brigada 123"
23000 Suharekë
Republika e Kosovës

Fax : +381 (0) 29 271 035
Tel : +383 (0) 44 501 168
Web : www.kk.rks-gov.net/suhareke/
Kjo shkres elektronike eshte e besueshme dhe e paraparë për përdorim vetem nga ata qe u eshte adresuar. Nese gabimisht e keni pranuar kete shkres elektronike, ju lutemi fshijeni ose na informoni me telefon apo shkrese elektronike

---

From: Avdullah Berisha
Sent: Friday, April 10, 2020 9:35 AM
To: Izedin Bytyqi
Cc: Ismail Rudari; Bali Muharremaj; Agim Bylykbashi
Subject: RE: Kerkese per Informata shtesë

Sqarime lidhur me Projektin: Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluake në Suharekë. MMPH në vitin 2018 kishte nënshkruar memorandum bashkëpunimi për ketë Projekt ne vlerë prej 3,500,000.00€ i ter buxheti i nder për ketë projekt ka shkuar ne suficit buxhetor, edhe ne vitin 2019 kishim te ndarë buxhetin për ketë Projekt ne vlerë prej 1,514,759.00€ qe i ter buxheti

ka shkuar ne suficit buxhetor, andaj gjet planifikimit buxhetit me Qarkoren e dytë buxhetore ketë projekt e ka hequr nga linjat buxhetore ish ministri z. Matoshi . Por i nderuar z. Kryetar ju kishte paralajmëruar edhe krye shefi ekzekutiv z. Ilir Morina përmes postes elektronike me datën 15 Nëntor qe ky Projekt nuk do te jetë ne buxhetin e vitit 2020.

From: Izedin Bytyqi
Sent: Tuesday, April 7, 2020 2:20 PM
To: Avdullah Berisha <Avdullah.Berisha@rks-gov.net>
Cc: Ismail Rudari <Ismail.Rudari@rks-gov.net>; Bali Muharremaj <Bali.Muharremaj@rks-gov.net>; Agim Bylykbashi <agim.bylykbashi@rks-gov.net>
Subject: FW: Kerkese per Informata shtesë

Avdullah,

Shiko emailin me poshte nga kryetari z. Muharremaj dhe te lutem sqaroje si eshte situate ne kete rast lidhur me kete kerkese.

Gjitha te mirat.

From: Bali Muharremaj
Sent: Tuesday, April 7, 2020 1:38 PM
To: Izedin Bytyqi <Izedin.Bytyqi@rks-gov.net>
Cc: Agim Bylykbashi <agim.bylykbashi@rks-gov.net>
Subject: Kerkese per Informata shtesë

I nderuar Sekretar Z. Izedin Bytyqi!

Uroj te jeni mir duke ju deshiruar suksese ne punë.

Po ju shkruaj për të marrë sqarime lidhur me Projektin Ndertimi i impiantit të mbeturinave recikluese në Suharekë.

Kete projekt Komuna e suharekes ka inicuar procedurat e prokurimit publik lidhur me meete projekt, mirpo kjo procedur është zgjatur per shkak te ankesave te paraqitura na Operatoret Ekonomik, dhe pas Vlersimet e Ri-vlersimeve, duke ju referuar vendimeve te OSHP-se.

Mirpo krejt qka na duhet është se a ka bugjet të Planifikuar nga Ministria për vitin 2020, pëete Projekt, pasi lenden e kemi ne Rivlersim dhe nuk dime se si te vazhdojm tutje, ngase ne nuk kemi pare qe ne Ligjin per bugjetin e Vitit 2020 nuk kemi hasur ne kete Projekt.

Andaj ju lutem qe te na ktheni pergjigjeje sa me pare se a është planifikuar bugjet per kete projekt per vitin 2020.

Se bashku me kete shkres gjeni edhe sqarimin e Drejtoriit tëEkonomise dhe Financa Komuna e suharekes, dhene Kryetarit.

Me nderime,

Bali Muharremaj
Mayor of Municipality of Suhareka
****
Kryetar i Komunës së Suharekës
Komuna Suharekë
Rr. "Brigada 123"
23000 Suharekë
Republika e Kosovës

Fax : +381 (0) 29 271 035
Tel : +383 (0) 44 501 168
Web : www.kk.rks-gov.net/suhareke/
Kjo shkres elektronike eshte e besueshme dhe e paraparë për përdorim vetem nga ata qe u eshte adresuar. Nese gabimisht e keni pranuar kete shkres elektronike, ju lutemi fshijeni ose na informoni me telefon apo shkrese elektronike

---

From: Agim Bylykbashi
Sent: Tuesday, April 7, 2020 9:44 AM
To: Bali Muharremaj
Subject: Sqarim

I nderuar kryetar ne baze te dhenave qe kemi ne si drejtori ne Buxhetin e vitit 2019(GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 4 / 14 SHKURT 2019, PRISHTINË) dhe (LIGJI NR. 06/L -133 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 20119) ne tabelen 3.2 te projekteve kapitale ne nivel qendror respektivisht ne faqen 166, projekti "Ndertimi i impiantit te mbeturinave ricikluese ne Suhareke" figuron ne kete tabele dhe atë; me kod.nr.21037-1935405 dhe me kod te projektit 18519 dhe ku jane te parapara keto mjete : Per vitin 2019 572,116.00 € nga BK dhe 1,227,884.00 € nga te hyrat nga AKP pastaj per vitin 2020 jane te parapara 700,000.00 € nga BK ndersa per vitin 2021 nuk ka mjete te parapara.
Ndersa ne buxhetin vitit 2020 ky projekt nuk figuron askund dhe nuk ka mjete te ndara per kete projekt.

Ne atach mund te gjeni Ligjin per ndarje buxhetore per vitin 2019 dhe 2020

Agim Bylygbashi-Drejtor në Drejtoria për Ekonomi,Financa dhe Buxhet
Komuna e Suharekes
email; agim.bylykbashi@rks-gov.net
tel; +383/44/323-725